

VENDIM
Nr. 297, datë 17.11.2025

MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 123, DATË 4.4.2023, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘SUN ENERGY SOLUTIONS’ SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 mw”

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.11.2025, mbasi shqyrtoi relacionin e për gatitur nga Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme, me nr. 2872 prot., datë 14.11.2025, “Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 123, datë 4.4.2023, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Sun Energy Solutions’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 mw”,

konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “Sun Energy Solutions” sh.p.k.

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 123, datë 4.4.2023, ka licencuar shoqërinë “Sun Energy Solutions” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në fshatin Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, për një afat 25-vjeçar.

- Në pikën 2 të vendimit 123/2023 përcaktohet se “Shoqëria duhet të informojë ERE-n çdo 2 (dy) muaj, në lidhje me fillimin e punimeve të ndërtimit të centralit fotovoltaik deri më datë 6.9.2024”.

- Gjithashtu, në pikën 3 të këtij vendimi, përcaktohet se: “Ky vendim është objekt rishikimi”.

2. Korrespondenca dhe dokumentacioni i depozituar nga shoqëria

- Shoqëria “Sun Energy Solutions” sh.p.k. ka depozituar pranë ERE-s raportimet periodike për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik për periudhën janar–shtator 2025. Nga shqyrtimi i këtyre raportimeve rezulton se shoqëria ka hyrë në prodhim dhe po ushtron veprimtarinë e saj, në përputhje me kushtet e përcaktuara në vendimin e licencimit.

3. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Shoqëria ka hyrë në prodhim përpara afatit të përcaktuar në pikën 2 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 123, datë 4.4.2023, duke përmbushur plotësisht kushtin e vendosur në vendim. Për rrjedhojë, ky kusht konsiderohet i realizuar dhe duhet të shfuqizohet.

- Me shfuqizimin e këtij kushti, duhet të shfuqizohet dhe pika 3 e vendimit 123/2023, e cila përcakton se ky vendim është objekt rishikimi, në kuadër të plotësimit të kushtit të përcaktuar në pikën 2.

4. Nevoja për ndryshimin e vendimit

- Në mbështetje të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se një akt administrativ mund të ndryshohet, shfuqizohet apo anulohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë për ta nxjerrë atë, vlerësohet se pikat 2 dhe 3 të dispozitivit të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 123, datë 4.4.2023, duhet të shfuqizohen, pasi shoqëria “Sun Energy Solutions” sh.p.k. ka përmbushur kushtin përkatës dhe duhet të reflektohet situata aktuale e realizimit të projektit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pikat 2 dhe 3 të vendimit të ERE-s nr. 123, datë 4.4.2023, shfuqizohen.

2. Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme, të njoftojë shoqërinë “Sun Energy Solutions” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, “OSSH” sh.a. dhe “ALPEX” sh.a., lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja, që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti